

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LALA GROUP” SH.P.K**

Sot, më datë 01/03/2024 (dy mijë e njezet e kater), Z ARDENIS LALA , shtetas shqiptar, i datëlindjes 05/05/2002, lindur në Gjirokaster, Memaliaj, dhe banues ne rrithin e Gjirokaster, bashkia Memaliaj Toç; Nd. 005; H. 0; Ap. 0; Krahës; Toç; kodi postar 6307; Memaliaj , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit me ID K00505032S vendosa te themeloj një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqerise eshte "LALA GROUP Sh.P.K, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri" LALA GROUP" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë. Eshte fitim prures .fusha e veprimtarise eshte kryesisht tregti .Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte veprimtari prodhuese dhe tregtare te aksesoreve ,orave etj .

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin "LALA GROUP " SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i shoqërisë është Prodhim dekorim dhe tregtim te orave si dhe ato lloj orash te punuara me gure te cmuar ,si dhe cdo veprimtari tjeter e kesaj fushe te lejuar nga legjislacioni shqiptar .

**NENI 5**  
**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në rrithin e Gjirokaster, bashkia Memaliaj Toç; Nd. 005; H. 0; Ap. 0; Krahës; Toç; kodi postar 6307; Memaliaj .

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**  
**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 3 000.000 (tre milion ) lek, 100 % Ortakja themelues Z ARDENIS LALA te Shoqërisë Tregtare "LALA GROUP " SH.P.K te cilet zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:**Z ARDENIS LALA** , shtetas shqiptare, i datëlindjes 05/05/2000 lindur në MEMALIAJ, dhe banues ne rrithin e Gjirokaster, bashkia Memaliaj Toç; Nd. 005; H. 0; Ap. 0; Krahës; Toç; kodi postar 6307; Memaliaj , mbajtës i kartes se identitet me id K00505032S zotërues i kuotave të përbërë nga 3.000.000(tre milion) lekë, duke përfaqesuar 100 %, të kapitalit shoqerise .

Kapitali themeltar do te shlyet plotesisht ne para nga Ortaket me themelimin e Shoqerise per nje periudhe 2 vjecare. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar

**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:  
Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;  
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

**NENI 8**  
**Administratori**

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë Z Ardemis Lala shtetase shqiptare e datelindjes 05/05/2024 lindur në Memaliaj, dhe banues ne rrëthin e Gjirokaster, bashkia Memaliaj Toç; Nd. 005; H. 0; Ap. 0; Krahës; Toç; kodi postar 6307; Memaliaj mbajtes i leter me ID K00505032S shtetas Shqiptar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, te cili ushtronë këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 10**

Ortaket themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 12**

Ortaket detyrohen të ruajne sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 13**

Mosmarëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

**NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u get sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa ërejtje. Ky Akt-Themeli i hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT THEMELUES**  
**Ardenis Lala**

